

UDHËZIM
Nr.20, datë 14.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E FORMAVE TË DEKLARIMIT TË NUMRAVE IMEI NGA
IMPORTUESIT DHE INDIVIDËT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Personat e tatueshëm që furnizojnë aparate celulare, detyrohen të deklarojnë me shkrim pranë degës së tatimeve ku janë regjistruar, inventarin gjendje në datë 30.9.2007 të aparateve celulare.

Në listën e inventarit jepet përshkrim i hollësishëm për markën e aparatit, tipin dhe numrin IMEI, respektiv.

Dega e tatimeve protokollon deklaratën dhe e administron atë në dosjen e tatimpaguesit, për ta përdorur gjatë kontrolleve tatimore.

Një listë përmbledhëse të të gjithë inventarëve, dega e tatimeve ua dërgon zyrtarisht operatorëve të telefonisë celulare.

2. Personat e tatueshëm që merren me tregtimin e aparateve celulare duke blerë e shitur brenda vendit, detyrohen të mbajnë kopje të faturave të blerjes dhe të shitjes, ku paraqitet numri IMEI i çdo aparati.

3. Personat e tatueshëm importues të aparateve celulare dhe individët, të cilët në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është mbi minimumin e patatueshëm, krahas deklarimit nëpërmjet DAV duhet të dorëzojnë në katër kopje listën e aparateve të importuara. Në listë duhet të specifikohen qartë dhe pa gabime, marka e aparatit, tipi dhe numri IMEI.

Pas çlirimit të aparateve celulare, dega doganore shënon në listë numrin dhe datën e zhdoganimit, vulos çdo faqe me vulën zyrtare dhe dërgon zyrtarisht me postë, brenda 72 orëve, nga një kopje për çdo operator të telefonisë së lëvizshme.

4. Personat e tatueshëm importues që merren me tregtimin e aparateve celulare detyrohen të mbajnë një kopje të formularit të deklarimit në doganë të numrave IMEI të aparateve të importuara prej tyre. Njëkohësisht në faturën e lëshuar për çdo shitje, krahas informacionit të detyrueshëm me ligj, të paraqesë edhe numrin IMEI të çdo aparati që shet.

5. Kur një person i tatueshëm nuk bën deklarimet si më lart, detyrohet të paguajë një dënim në masën 10 000 lekë për çdo numër IMEI të padeklaruar.

6. Individët të cilët në çastin e hyrjes në territorin doganor shqiptar disponojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është nën minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë pranë shërbimit doganor deklaratën “Modeli 1”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Në të gjitha rastet kur për vlerën e aparatit nuk mund të zbatohen nenet 508, 509 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, bëhet zhdoganimi i tij dhe më pas plotësohet “Modeli 1” bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Formulari “Modeli 1” ka numër serial dhe plotësohet në 5 kopje.

Kopja e parë mbahet nga Dega doganore, e dyta i lihet udhëtarit dhe tri kopjet e tjera dërgohen zyrtarisht nga një për çdo operator të telefonisë së lëvizshme.

9. Ngarkohet DPD-ja të bëjë furnizimin e të gjitha doganave kufitare me formularin “Model 1” dhe të bëjë publikimin në të gjitha pikat e kalimit kufitar të detyrimit që kanë udhëtarët për deklarimin e aparateve GSM.

10. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët e saj.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MODEL 1

**DREJTORIA E PERGJITHSHME E
DOGANAVE**

Dega e Doganes _____

Dt _____

Nr serie

Firma

Vula

Deklarim Aparati Celular GSM

Emri _____ Mbiemri _____ Nr _____

Pasaporte _____

Marka _____ Tipi _____ IMEI _____

Vlera e Aparatit _____ Monedha _____